

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “Marina di Valona” sh.p.k. / NUIS M01324008A, “Marina Projects” ltd / me numër regjistrimi në Angli 04182366, “Brunes” sh.p.k. / NUIS K37125203H dhe “Ndregjoni” sh.p.k. / NUIS K37125203H, me adresë: Farkë, Lundër Lobby Home, Rruga Nacionale Tiranë - Elbasan, Tiranë.

Procedura konkurruese: Dhënia me Koncesion/PPP të një porti turistik në qytetin e Vlorës “Marina Vlorë”, propozim i pakërkuar.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Projektim, financim, ndërtim, vënie në operim, administrim dhe mirëmbajtjen e një porti turistik në qytetin e Vlorës “Marina Vlorë”, me vendndodhje në qytetin e Vlorës dhe konkretisht në portin aktual të këtij qyteti. Kohëzgjatja e kontratës së Koncesionit/PPP: 35 vjet.

Buletini i njoftimeve Publike nr. 3 datë 11.01.2021.

Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në procedurë këto ofertues me ofertat përkatëse të ofruara:

- Shoqëria “Albavia” sh.p.k me vlerë investimi prej 1’876’427’700 lekë pa TVSH.
- Shoqëria “Gjikuria” sh.p.k me vlerë investimi prej 22’725’572 Euro pa TVSH.
- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Marina di Valona” sh.p.k. / NUIS M01324008A, “Marina Projects” ltd / me numër regjistrimi në Angli 04182366, “Brunes” sh.p.k. / NUIS K37125203H dhe “Ndregjoni” sh.p.k. / NUIS K37125203H, me vlerë investimi prej 22’842’417 Euro pa TVSH.

Është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1. Shoqëria “Albavia” sh.p.k
2. Shoqëria “Gjikuria” sh.p.k

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Shoqëria “Albavia” sh.p.k është skualifikuar sepse nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës sipas shtojcës nr. 3 të DPK, sipas kërkesës së germës a) pika 1 të pikës 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të shtojcës nr. 9 të DPK. Gjithashtu, nuk është dorëzuar i gjithë dokumentacioni i kërkuar në shtojcën nr. 9 të Dokumenteve të Koncesionit/PPP.

Shoqëria “Gjikuria” sh.p.k është skualifikuar sepse nuk ka paraqitur Raportin e auditimit financiar të vitit ushtrimor 2018, (përfshirë opinionin e auditorit), të certifikuara nga një subjekt i jashtëm i licencuar audit; nuk ka plotësuar kriterin financiar nr. 2 “Kapitali i Vet (totali i aktivitet minus totalin e detyrimeve) i vitit të fundit ushtrimor (2019) të jetë të paktën sa 40% (dyzet përqind) e vlerës së investimit të përgjithshëm (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi”; nuk ka paraqitur Dokumente të lëshuara nga institucione financiare të besueshme, këto sipas kërkesës së nënpikës 1.2. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të pikës 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të shtojcës nr. 9 të DPK. Gjithashtu, nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të zërit “Projektim”, pasi nuk ka dorëzuar një Licencë të vlefshme Profesionale, si dhe Ofertuesi nuk ka paraqitur eksperiencë të provuar të dizejnit dhe shpërndarjes së marinave të klasit botëror që i lejon ata të arrijnë njohjen e industrisë dhe akreditim ndërkombëtar, sipas kërkesës të pikës 3 të nënpikës 1.3. “Kapaciteti teknik” të pikës 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të shtojcës nr. 9 të DPK.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “Marina di Valona” sh.p.k. / NUIS M01324008A, “Marina Projects” ltd / me numër regjistrimi në Angli 04182366, “Brunes” sh.p.k. / NUIS K37125203H dhe “Ndregjoni” sh.p.k. / NUIS K37125203H, me adresë Farkë, Lundër Lobby Home, Rruga Nacionale Tiranë - Elbasan, Tiranë, se oferta e paraqitur më datë 26 Shkurt 2021, për marrjen me Koncesion/PPP të një porti turistik në qytetin e Vlorës “Marina Vlorë”, është pranuar.

Afati i negociimit të Kontratës tuaj do të jetë 60 ditë nga marrja e njoftimit të fituesit.

Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Marina di Valona” sh.p.k. / NUIS M01324008A, “Marina Projects” ltd / me numër regjistrimi në Angli 04182366, “Brunes” sh.p.k. / NUIS K37125203H dhe “Ndregjoni” sh.p.k. / NUIS K37125203H, kërkohet t’i paraqesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dokumentet e mëposhtme:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare/Partneritetit Publik Privat, të nënshkruar.
- Sigurimin e Kontratës sipas formës së kërkuar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese, në vlerën 5 % të vlerës së investimit (pa TVSH). Sigurimi duhet të paraqitet jo më vonë se në momentin e nënshkrimit të Kontratës nga të dy palët.
- Ofertën origjinale e shtypur/printuar ose e shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi me të drejtë nënshkrimi (i autorizuar me prokurë) duhet të nënshkruajë Ofertën duke nënshkruar origjinalin e ofertës dhe firmosur në secilën faqe të origjinalit të dokumenteve që shoqërojnë ofertën ekonomike.
- Në rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë 11.03.2021.

Ankesa: Nuk ka